



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 08.06.2023

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
(KABK)
2024 – 2026**

1. Qëllimi

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2024-2026 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2024. Qëllimi kryesor i KABK-së është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Kjo kornizë e buxhetit për vitet 2024-2026 bazohet në KASH 2024-2026 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Korniza është hartuar në bazë të Strategjisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik 2016-2020, Qarkores Buxhetore 2024/01 të lëshuar nga MFPT, Qarkores së Brendshme Buxhetore Komunale 2024/01, LMFP të nenit 20 etj. Komuna (DBF) ka për detyrë ta dorëzojë këtë kornizë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të aprovuar nga Kuvendi Komunal, deri më **30 qershor të vitit aktual**.

2. Objektivat e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2024–2026 planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në “Buxhetin e programeve” dhe është i bazuar në objektivat e Komunës. KAB Komunale 2024–2026 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2024/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Objektivat e Komunës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Përfshirja e tërësishme në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesës së Qeverisë për përgatitjen e buxhetit në kohën e duhur, thelbësore është që të gjitha drejtoritë të veprojnë në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuara në këtë Kornizë. KAB Komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e planeve, politikave dhe resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, me qëllim që të demonstrojë qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare, si dhe projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. KAB duhet të përcaktojë këto fusha përkatëse për tri vitet vijuese fiskale:

- Vlerësimin e të hyrave nga të gjitha burimet;
- Vlerësimet e hershme (nëpër kategoritë ekonomike);
- Programi i investimeve publike.

Në KAB janë paraqitur tabelat që prezantojnë shpërndarjen e grantit, projeksionin e të hyrave të drejtorive nga të gjitha burimet, investimet kapitale, ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve, si dhe masat dhe rekomandimet tjera, etj.

3. Shpërndarja e granteve

Në tabelat e poshtëcekura (1,2) kemi të dhënat e shpërndarjes së granteve për komunën tonë, të aprovuara nga Komisioni i Granteve që është mbajtur në muajin prill të këtij viti, nga Qarkorja Buxhetore 2024/1, nr. pr. 1026/2023 të datës 15.05.2023 të lëshuar nga MFPT-ja.

- **Granti i përgjithshëm** - Granti i Përgjithshëm për Komuna për vitin 2024, në shumë prej 284.68 milionë euro, është aprovuar nga Komisioni i Granteve.
Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL-së. Sipas këtij neni komunave u ndahen 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore. Me qëllim të nivelimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL-së: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë për qind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë për qind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë - me tre për qind (3%); (iv) komunat në të cilat shumica e popullsisë përbëhet nga pakicat - me dy për qind (2%).
- **Granti specifik për arsim sipas LFPL-së** - Granti specifik për arsim parauniversitar sipas LFPL-së bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHTI-t për vitin 2024-2026.
Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 238.5 milion euro, si në vijim.
 - Paga dhe shtesa në shumë prej 223 milion euro,
 - Mallra dhe shërbime në shumë prej 13.2 milion euro,
 - Shpenzime kapitale në shumë prej 2.3 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2022/2023;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2,

dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;

- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës - 1 punëtor në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës - 1 punëtor në arsimin e mesëm;
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës - 1 punëtor (pastrues) si dhe 1 punëtor për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
- q) Praktika profesionale;
- r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 shkolla);
- s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë, klasa 6 deri 9;
- t) Specialist të IT-së.

Krahasuar me vitin paraprak, sipas MASHTI-t, është raportuar numri për 9,859 nxënës më pak në arsimin parauniversitar.

Numri i synuar për reduktim të 485 pozitave të lira ka të bëjë me mosplotësimin e tyre duke pasur parasysh faktin që këto pozita janë mbi formulën e financimit për arsimin parauniversitar.

Po ashtu, në rastet kur numri aktual është mbi numrin e lejuar sipas formulës së financimit, me rastin e pensionimit të stafit aktual nuk do të ketë punësim të ri me qëllim të arritjes së synimit për respektimin e numrit sipas formulës së financimit.


➤ **Granti specifik për shëndetësi primare** - Propozimi, granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 81.96 milion euro, si në vijim:

- ✓ Granti bazë do të jetë në shumë prej 76.5 milion euro, granti bazë është kalkuluar duke marrë për bazë:
 - kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej 62.3 milion euro,
 - koston për vizitë dhe shërbim në shume prej 14.2 milion euro.
- ✓ Politikat në vazhdimësi me kosto prej 5.4 milion euro të cilat janë:
 - Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë (vizita x 10 euro) në shumë prej 3.4 milion euro,
 - Vizitat e kujdesit paliativ (vizitë x 20 euro) në shumë prej 2 milion euro.

Tabela 1. Shpërndarja e granteve dhe të hyrave komunale 2024-2026

Organizata buxhetore	Buxheti	Plani i buxhetit për vitet		
	2023	2024	2025	2026
Granti i Përgjithshëm	4,916,458.00	5,480,065.00	5,887,289.00	6,269,919.00
Granti i Arsimit	4,881,649.00	5,278,623.00	5,436,981.95	5,600,091.00
Granti i Shëndetësisë	1,490,427.00	1,812,205.00	1,902,815.00	1,997,956.00
Të Hyrat Vetanake	3,805,401.00	3,714,607.00	3,871,011.00	4,070,799.00
Huamarrja në Shëndetësi		-		
TOTALI	15,093,935.00	16,285,500.00	17,098,096.95	17,938,765.00

% e Rritjes së granteve, THV dhe buxhetit për vitin 2024



4. Projektionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2024 dhe parashikimet 2025-2026

Projektionet e të hyrave vetanake komunale në shkallë vendi, për vitin 2024, bazuar në vlerësimet makro-fiskale janë në shumë prej 98.5 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të “Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale”, “Rregullores për Tatimin në Pronë” si dhe dispozitave tjera ligjore (Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr. 03-L-049), të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat komuna ka të drejtë të caktojë dhe inkasojë të hyrat komunale:

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2024-2026

Burimet e të Hyrave	Buxheti projeksionet		
	2024	2025	2026
Grantet qeveritare	12,570,893.00	13,227,085.95	13,867,966.00
Totali i të hyrave vetanake	3,714,607.00	3,871,011.00	4,070,799.00
Taksa për regjistrimin e automjeteve	120,000.00	125,000.00	130,000.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	1,503,093.00	1,485,632.00	1,548,458.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë-bartja e pronës	68,000.00	70,000.00	80,000.00
Taksë adm.(Cert. e lind.,kurorëzim., vdekjes,shtet., etj)	45,000.00	55,000.00	51,000.00
Taksa administrative-fletëkërkesat	30,000.00	33,000.00	35,000.00
Taksa per legalizimin e objekteve	50,000.00	55,000.00	60,000.00
Taksa ndërrimi i destinimit të tokës	180,000.00	190,000.00	200,000.00
Taksa për ushtrimin e veprimtarisë-biznese	9,876.00	13,000.00	15,000.00
Leje mjedisore komunale	75,000.00	80,000.00	90,000.00
Parcializim (Aktivitetet në terren që bëjnë matjen e vendit)	20,000.00	22,000.00	24,000.00
Licencimi i reklamave publike në pronën publike	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Regjistrimi i pengut - hipoteka	25,000.00	27,000.00	28,000.00
Licencimet tjera - zgjatja e orarit të punës	1,000.00	2,005.00	3,000.00
Inspektimet (ushqimore, higjieniko-sanitare, veterinë, etj)	5,000.00	6,000.00	7,000.00
Të hyrat nga shërbimet e ndryshme (qiraja, etj.)	10,000.00	16,000.00	18,000.00
Të hyrat nga shër. e ndryshme (Kopja e pl.,)	69,000.00	75,000.00	75,000.00
Të hyrat nga tatimi në pronë	1,165,198.00	1,199,604.00	1,265,959.00
Të hyrat nga tatimi në tokë	230,871.00	236,942.00	248,652.00
Të hyrat nga arsimi	70,000.00	90,000.00	100,000.00
Të hyrat nga shëndetësia	35,000.00	38,000.00	44,000.00
Të tjera -	15,445.00	69,833.00	69,730.00
TOTALI ;	16,285,500.00	17,098,096.95	17,938,765.00

5. Buxhetimi i programeve

Do të bëhet sipas programeve dhe nënprogrameve të administratës, të arsimit dhe të shëndetësisë. Nga drejtorët do të kërkohet të përcaktojnë se në cilat programe do të bëhet shpërndarja e fondeve, si dhe shumën që do të vihet në dispozicion me buxhet për secilin program. Transferet në mes të programeve do të kufizohen

gjatë vitit buxhetor 2024, ndërsa Drejtorët e Programeve do të jenë përgjegjës dhe të autorizuar për bërjen e shpenzimeve nga programet e tyre.

Buxhetet Komunale 2024 - 2026 do të përgatiten nëpër të gjitha kategoritë ekonomike për shpenzimet e buxhetuara, të definuara sipas Thesarit, e që janë: “Paga e mëditje”, “Mallra e shërbime”, “Shërbime komunale”, “Subvencione e transfere” dhe “Shpenzime kapitale”.

6. Shfrytëzimi i vlerësimeve të hershme

Ky buxhet aktual nënkupton që kostoja e vlerësuar e programeve të vazhdueshme komunale do të publikohet për buxhetin në dy vitet vijuese (këto dy vite referohen si vlerësime të hershme). Edhe pse publikohet buxheti trevjeçar, vetëm fondet për vitin aktual buxhetor do të ndahen në bazë të parasë së gatshme, shih tabelat nr. 3,4 dhe 5.

Tabela 3. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2024

Kodet e Progra m.	Programet/ nën-programet	Stafi 2024	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	14	146,992.00	25,046.80		40,000.00		212,038.80
16302	Administrata e Personelit	17	134,705.00	30,035.20				164,740.20
16422	Regjistrimi civil	8	59,008.12	5,500.00				64,508.12
16502	Çështjet gjinore	2	16,393.61	5,000.00		5,000.00		26,393.61
16603	Inspektimet	9	85,155.80	30,000.00				115,155.80
16902	Zyra e Kuvendit		243,635.87	17,000.00				260,635.87
17502	Buxhet dhe Financa	9	77,300.13	16,550.00			1,484,000.00	1,577,850.13
18162	Shërbimet publike	9	81,379.68	888,506.00	170,000.00	30,000.00	360,000.00	1,529,885.68
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	37,040.85	4,000.00				41,040.85
19710	Z.K.K	5	37,631.01	7,500.00				45,131.01
47042	Bujqësia	10	83,867.00	20,760.00		155,000.00		259,627.00
48002	Zhvillimi Ekonomik	9	72,753.63	15,000.00				87,753.63
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	10	82,676.65	15,000.00				97,676.65
16542	D. e Teknologjisë Inov.dhe Integr.Evrop.	4	42,470.51	20,030.00				62,500.51

18002	Drejtoria e Infrastrukturës	8	83,159.89	20,850.00			1,035,000.00	1,139,009.89
66015	Planifi. Urban dhe Mjedis	12	101,633.86	16,000.00				117,633.86
73011	Administrata e Shëndetësisë	4	38,440.16	132,870.00	60,000.00	400,000.00	430,000.00	1,061,310.16
73150	Shërbimet e shënd.primare	160	1,303,461.00	300,000.00				1,603,461.00
75506	Shërbimet Sociale	10	77,964.02	27,817.00	7,000.00			112,781.02
85002	K. R. dhe Sport	14	105,861.00	55,000.00		194,607.00	400,000.00	755,468.00
92010	Administrata e Arsimit	6	56,078.00	101,560.00		300,000.00	940,000.00	1,397,638.00
92230	Arsimi Para. dhe Çerdhet	49	233,630.74	56,000.00	21,000.00			310,630.74
93030	Arsimi Fillor	548	4,083,751.00	260,000.00	70,000.00			4,413,751.00
94230	Arsimi i Mesëm	83	716,578.47	90,300.00	22,000.00			828,878.47
TOTALI		1005	8,001,568.00	2,160,325.00	350,000.00	1,124,607.00	4,649,000.00	16,285,500.00

Shpërndarja e Buxhetit për vitin 2024 në mënyrë grafike




Tabela 4. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2025

Kodet e Program.	Programet/ nën-programet	Stafi 2025	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	15	153,886.19	27,200.00		40,700.00		221,786.19
16302	Administrata e Personeli	18	141,598.33	40,000.00				181,598.33
16422	Regjistrimi civil	8	60,008.12	5,800.00				65,808.12
16502	Çështjet gjinore	3	24,299.77	5,800.00		5,500.00		35,599.77
16603	Inspektimet	12	94,328.11	40,000.00				134,328.11
16902	Zyra e Kuvendit		244,635.87	18,900.00				263,535.87
17502	Buxhet dhe Financa	9	85,275.86	17,500.00			120,000.00	222,775.86
18162	Shërbimet Publike	9	79,797.57	900,000.00	175,500.00	30,000.00	1,862,011.00	3,047,308.57
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	38,040.85	5,550.00				43,590.85
19710	Z.K.K	5	38,631.01	8,600.00				47,231.01
47042	Bujqësia	10	84,500.00	21,600.00		180,000.00		286,100.00
48002	Zhvillimi Ekonomik	9	72,950.63	15,600.00				88,550.63
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	10	83,500.65	16,500.00				100,000.65
16542	D. e Teknol. Inovaci. dhe Inte. Evrop.	5	62,481.86	35,500.00				97,981.86
18002	D. për Infrastrukt.	9	90,762.89	30,550.00			1,015,000.00	1,136,312.89
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	12	103,000.00	17,850.00				120,850.00
73011	Administr. e Shëndetësisë	4	38,930.00	200,000.00	65,000.00	400,000.00	200,000.00	903,930.00
73150	Shërbimet e Shëndetësisë Primare	163	1,409,998.07	380,000.00				1,789,998.07
75506	Shërbimet Sociale	10	78,500.00	320,000.00	7,500.00			406,000.00
85002	K.R. dhe Sport	14	106,811.26	57,000.00		200,000.00	750,000.00	1,113,811.26
92010	Administrata e Arsimit	7	62,903.4	104,500.00		350,000	375,000.00	892,403.40

92230	Arsimi Parashkollor dhe Çerdhet	46	335,365.78	57,500.00	21,600.00			414,465.78
93030	Arsimi Fillor	539	4,192,247.37	300,000.00	73,200.00			4,565,447.37
94230	Arsimi i Mesëm	98	804,682.36	91,200.00	22,800.00			918,682.36
TOTALI		1020	8,487,135.95	2,717,150.00	365,600.00	1,206,200.00	4,322,011.00	17,098,096.95

Shpërndarja e Buxhetit për vitin 2025 në mënyrë grafike





Tabela 5. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2026

Kodet e Program.	Programet/ nën programet	Stafi 2026	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione e Transfere.	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	15	164,546.00	28,749.27		50,000.00		243,295.27
16302	Administrata e Personeli	19	149,647.29	41,350.00				190,997.29
16422	Regjistrimi civil	8	61,450.50	6,000.00				67,450.50
16502	Çështjet gjinore	3	25,358.00	6,000.00		6,000.00		37,358.00
16603	Inspektimet	12	95,482.00	41,000.00				136,482.00
16902	Zyra e Kuvendit		245,745.80	19,000.00				264,745.80
17502	Buxhet dhe Financa	10	93,139.36	18,200.00			1,050,000.00	1,161,339.36
18162	Shërbimet Publike	10	87,512.71	901,000.00	180,000.00	31,000.00	2,059,299.00	3,258,811.71
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	39,500.00	6,000.00				45,500.00
19710	Z.K.K	5	39,654.01	8,800.00				48,454.01
47042	Bujqësia	10	85,880.00	22,000.00		185,000.00		292,880.00
48002	Zhvillimi Ekonomik	9	79,547.99	17,300.00				96,847.99
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	10	90,098.01	15,800.00				105,898.01
16542	Tekno. Ino. dhe Integri.Evropiane	5	72,202.87	40,000.00				112,202.87
18002	Infrastrukturë	9	99,627.48	30,700.00			793,994.36	924,321.84
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	104,540.00	18,000.00				122,540.00
73011	Administr. e shëndetësisë	5	46,673.92	210,000.00	70,000.00	405,000.00	250,000.00	981,673.92
73150	Shërbimet e shën. primare	179	1,420,982.07	400,000.00				1,820,982.07
75506	Shërbimet Sociale	10	79,000.00	330,000.00	8,000.00			417,000.00
85002	K.R. dhe Sport	14	107,550.26	60,000.00		202,000.00	500,000.00	869,550.26
92010	Administrata e Arsimit	7	62,903.40	105,500.00		351,000.00	245,000.00	764,403.40
92230	Arsimi para. dhe çerdhet	60	375,365.78	58,000.00	21,800.00			455,165.78
93030	Arsimi Fillor	552	4,224,044.56	303,00.000	73,700.00			4,600,744.56
94230	Arsimi i Mesëm	100	805,220.36	91,900.00	23,000.00			920,120.36
TOTALI		1,069	8,655,672.37	2,778,299.27	376,500.00	1,230,000.00	4,898,293.36	17,938,765.00

Shpërndarja e Buxhetit për vitin 2026 në mënyrë grafike



8. Programi i Investimeve (Kapitale) Publike – PIP

Në tabelën nr.8 janë paraparë investimet kapitale për periudhën trevjeçare. Këto propozime janë vlerësime të hershme të cilat mund të ndryshohen nga kërkesat e qytetarëve, brenda kufijve buxhetor. Nga drejtoritë do të kërkohej të përgatisin analizat e PIP-së për të gjitha projektet e investimeve publike. Propozimet që nuk përmbajnë analizat e PIP- së nuk do të merren parasysh për financim. Propozimet e PIP- së do të përfshijnë, si ato për shqyrtim të financimit nga BKK-ja dhe të hyrat vetanake, ashtu edhe ato që propozohen për financim nga donatorët. Ato duhet të përfshijnë projekte që do të niseshin në vitet 2024, 2025 dhe 2026, jo vetëm projektet që fillojnë në vitin 2024.

Ne kërkojmë nga drejtorët e drejtorive që të fillojnë me përgatitjen e kërkesave të tyre për projektet kapitale, sa më herët që është e mundur. Kjo do të ndihmonte në shmangien e vonesave pasuese! Propozimet e projekteve që janë dorëzuar në procesin e PIP- së vitin e kaluar, por që nuk janë financuar, mund të dorëzohen sërish.

Tabela 6. Programi Komunal i Investimeve Publike (PIP) 2024 – 2026

Nr .	Kod. Fun.	Ko. pr.	Emri i Projektit	Plani 2024 nga i cili:			Projeksi. 2025	Projeksi. 2026
				Kostoja totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake		
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
			SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	4,649,000.0	2,059,000.0	2,590,000.	5,322,011	4,898,293
			612175 - Buxhet dhe Financa	1,484,000.0	384,000	1,100,000	1,120,000	1,050,000
1	0112		Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të Komunës	1,484,000.0	384,000.00	1,100,000	1,120,000	1,050,000
			612180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia	360,000.00	280,000.00	80,000.00	1,862,011	2,059,299
			18162-Infrastrukturë Publike		280,000.00	80,000.00		
2	0451		Ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavorr dhe kanaleve kulluese të ujërave atmosferike në fshatrat e Komunës së Fushë-Kosovës	40,000.00		40,000.00	80,000	64,599
3	0451		Ndërtimi i urave, shtratit të lumenjve, liqeneve, përroskave, etj.	40,000.00		40,000.00	100,000	
4	0451		Riparimi i rrugëve të asfaltuara	140,000.00	140,000.00		239,011	200,000
5	0451		Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre	100,000.00	100,000.00		100,000	50,000
6	0451		Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	40,000.00	40,000.00		43,000	44,700
7	0451		Vendosja e kamerave nëpër vendbanime (për sigurinë e qytetarëve në tërë territorin e komunës)				100,000	300,000
8	0451		Rregullimi i sheshit në lagjen Dardania				800,000	800,000
9	0451		Ngrohja solare në institucionet (Administratë, QKMF, Arsim)				400,000	600,000

	18002-Infrastrukturë Rrugore			1,035,000.0	1,005,000.0	30,000.00	1,015,000	793,994
10	0451		Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave të reja rekreative, këndi i lojërave, mbjellja e pemëve dekorative, dhe vendosja e shportave nëpër vendbanime	200,000.00	200,000.00		100,000	100,000
11	0451		Rregullimi i parkut rekreativ ne B. të Madh, S. të Madhe, S. të Vogël, Harilaq	50,000.00	50,000.00		100,000	88,994
12	0451		Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve në vendbanime	20,000.00		20,000.00	150,000	130,000
13	0451		Ndërtimi i rrethojës, platesë, me infrastrukturë përcjellëse në oborrin e Komunës dhe QKMF-së	240,000.00	240,000.00			
14	0451		Ndërtimi i rrethojave për siguri në komunikacion në vendet: Vrogoli, Sllatinë e Madhe.				30,000	
15	0451		Shtyllat antiparking dhe pistonet lëvizëse				30,000	
16	0451		Asfaltimi në Fushë-Kosovë	150,000.00	150,000.00		165,000	150,000
17	0451		Asfaltimi në Graboc	20,000.00	20,000.00		20,000	10,000
18	0451		Asfaltimi në Bardh të Madh	35,000.00	35,000.00		45,000	50,000
19	0451		Asfaltimi në Bardh të Vogël	15,000.00	15,000.00		10,000	10,000
20	0451		Asfaltimi në Sllatinë të Madhe	35,000.00	35,000.00		40,000	30,000
21	0451		Asfaltimi në Sllatinë të Vogël	20,000.00	20,000.00		10,000	10,000
22	0451		Asfaltimi në Vragoli	20,000.00	20,000.00		20,000	20,000
23	0451		Asfaltimi në Miradi të Epërme	15,000.00	15,000.00		30,000	35,000
24	0451		Asfaltimi në Nakaradë	90,000.00	90,000.00		50,000	20,000
25	0451		Asfaltimi në Harilaq	20,000.00	20,000.00		15,000	10,000
26	0451		Asfaltimi në Henc	20,000.00	20,000.00		15,000	10,000
27	0451		Asfaltimi në Lismir	20,000.00	20,000.00		20,000	20,000
28	0451		Asfaltimi në Kuzmin	10,000.00	10,000.00		20,000	10,000
29	0451		Asfaltimi në Pomozotin	15,000.00	15,000.00		20,000	20,000
30	0451		Asfaltimi në Miradi të Poshtme	30,000.00	30,000.00		25,000	20,000
31	0451		Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit (qytet, fshatra)	10,000.00		10,000.00	100,000	50,000
	612730 - Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale			430,000.00	200,000.00	230,000.00	200,000	250,000
32	0760		Pajisje Mjekësore për QKMF	50,000.00	50,000.00		50,000	50,000
33	0760		Ndërtimi i QMF-së në Fushë-Kosovë	350,000.00	120,000.00	230,000.00		
34	0760		Blerja e inventarit për QMF	30,000.00	30,000.00			

35	0760		Ndërtimi i shtëpisë për përkujdesjen e të moshuarve				150,000	200,000
612850 - Kulturë, Rini dhe Sport				400,000.00		400,000.00	750,000	500,000
36	0820		Renovimi dhe zgjerimi i stadiumit të qytetit "Ekrem Grajqevci", Fushë-Kosovë	400,000.00		400,000.00	200,000	
37	0820		Renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik në shkollat: M.Grameno, D.Bogujevci, V.Frashëri, M.Epërme, Laura Schooti, B.Curri - Sllatinë				100,000	
38	0820		Renovimi i stadiumit në Bardh të Madh				50,000	
39	0820		Renovimi i stadiumit në Miradi të Epërme				50,000	
40	0820		Renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik te shkollat: B.Curri- Henc, V.Frashëri-Vragoli, Z.Saliu-Pomozotin, Lismiri- Lismir				150,000	
41	0820		Ndërtimi i qendrës multifunksionale me objekte përcjellëse				200,000	500,000
612920 - Arsimit dhe Shkencë				940,000.00	190,000.00	750,000.00	375,000	245,000
42	0980		Ndërtimi i shkollës fillore në Fushë-Kosovë	500,000.00	150,000.00	350,000.00	175,000	150,000
43	0980		Blerja e inventarit për shkollat	40,000.00	40,000.00		100,000	45,000
44	0980		Rregullimi i rrethojave të shkollave				100,000	
45	0980		Renovimi i objekteve shkollore					50,000
46	0980		Ndërtimi i dy çerdheve në Fushë-Kosovë	400,000.00		400,000.00		

9. Fazat e procesit buxhetor 2024 - 2026

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit komunal dhe ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2024 – 2026.

Hapi 1: Shqyrtimi i prioriteteve nga drejtoritë komunale

Ky hap kërkon nga drejtoritë që të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Në pajtim me prioritetet e gjera të komunës (kur janë në dispozicion) secila drejtori duhet të ofrojë gjithashtu listën përmbledhëse të propozimeve të politikave të reja me prioritet që do të propozohen për procesin buxhetor komunal 2024 - 2026 (d.m.th. që pritet të fillojnë për çdo vit), bashkë me opsionet për kursimet e mundshme në programet e prioritetit të ulët dhe me performancë të dobët.

Shqyrtimi i prioriteteve do t'iu mundësojë drejtorëve që të garojnë në procesin e përcaktimit të prioriteteve, në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor. Nëse propozimi apo opsioni aprovohet (në parim) nga Bordi i Drejtorëve gjatë

këtij procesi fillestar të shqyrtimit të prioriteteve, drejtoria do të bëjë kërkesë më të hollësishme, si pjesë e materialit buxhetor, në fazat e mëvonshme të procesit buxhetor.

Hapi 2: Dorëzimi i buxhetit

Dorëzimet e materialeve buxhetore janë mjete përmes të cilave drejtoritë bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve të hollësishme të politikave të reja, si dhe opsioneve për kursime në kontekst të strategjisë afatmesme fiskale (dhe në pajtim me kufijtë fillestar buxhetor). Dorëzimi buxhetor duhet të dizajnohet për të thjeshtësuar mbledhjen e informatave. Me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme dhe duke njohur faktin që shumica e programeve komunale vazhdojnë nga një vit në tjetrin, në fokus të marrjes së vendimeve rreth buxhetit do të jenë propozimet për programet shpenzuese të reja dhe/apo plotësuese si dhe ato që u nënshtrohen kursimeve potenciale në kontekst të pozitës aktuale fiskale.

Hapi 3: Dëgjimet buxhetore

Kur të ketë kaluar afati kohor i specifikuar me Qarkoren Interne Buxhetore Komunale 1, 2, ZKF-ja do të shqyrtojë buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga njësitë funksionale. Drejtoritë dhe sektorët do të mbajnë seanca dëgjimore me qëllim të shqyrtimit dhe të kuptuarit të buxheteve të propozuara, me qëllim të përpjekjes për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësimeve lidhur me buxhetet e propozuara, veçmas për sa i përket pajtueshmërisë së tyre me kufijtë fillestar specifik të drejtorive. Qytetarët do të njoftohen me kohë rreth dëgjimeve buxhetore (dy javë para mbajtjes) përmes shtypit ditor, web-faqes së Komunës, mediave elektronike dhe njoftimeve publike.

Koha e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore:

Dëgjimet buxhetore me qytetarë mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës:

- 1. Më 07 korrik 2023, ora 10:00**
- 2. Më 21 korrik 2023, ora 10:00**
- 3. Më 25 gusht 2023, ora 10:00**

Hapi 4: Shqyrtimi i buxhetit komunal

Kur Kryetari, së bashku me drejtorët e drejtorive, të ketë aprovuar buxhetin e propozuar komunal për tri vitet e ardhshme fiskale, përfshirë këtu edhe dokumentet përcjellëse ashtu si kërkohet nga MEF-i, atëherë Kryetari bën dorëzimin e dokumenteve të buxhetit të propozuar në KPF dhe në Kuvendin e

Komunës. Dokumentacioni Përmbledhës i Buxhetit për publikim, shpërndarje dhe shfrytëzim nga ana e Kuvendit të Komunës, dhe opinionit publik gjithashtu, do të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e detajuar të buxhetit. Kuvendi bën shqyrtimin e tyre në takimin e rregullt të radhës, apo në ndonjë takim special të ftuar më herët, me qëllim të shqyrtimit të atyre dokumenteve. Rekomandohet që Kuvendi i Komunës të organizojë takim të paralajmëruar në mënyrë adekuate, ku kërkohet nga opinionin publik, kontributi i tyre në lidhje me buxhetin, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Ky takim duhet të jetë i mbuluar nga mediat, buxheti publik të adresohet nga ZKF-ja dhe Kryetari i Kuvendit të Komunës, ndërsa rekomandohet që të jetë ky një takim i hapur me publikun, në përputhje me rregulloret.

10.Kalendari kohor

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim-buxhetit:

- 30 qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 shtator: Aprovimi i propozim-buxhetit komunal për vitin 2024-2026 nga Kuvendi Komunal,
- 30 shtator: pas aprovimit të propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet si në vijim:
- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2024-2026, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
- Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB-se dhe PIP):
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2024-2026 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2024 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2024-2026 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator.

Planifikues i Buxhetit
Ma. Bardhyl Koçiçi

Drejtor i Drejtorisë
Ramadan Jashanica